REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 900/20
Datë/Datum. 06.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **" KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN"**

Për Aktivitetin e Prokurimit : **613-20-2177-5-2-1**

Sa i përket tenderit për : **"Ndërtimi i shtigjeve të ecjes rreth shtratit të lumit Sitnica"**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Grupi i OE "PARAJSA" SH.P.K& N.N.SH "EMSA"

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Bajram Gashi pn.
(Adresa)

Lipjan *(Vendi)*

14 000 *(Kodi postar)*

+383 44 381 879 *(Numri Telefonit)*

(Numri i Faks-it)

Pajtim LUBOVCI
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

parajsa.lipjan@hotmail.com
(Adresa elektronike)

06.11.2020
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar "PARAJSA" • LIPJAN •

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

4. Procesi i Hapjes se tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [x] Jo [ ]

Procesverbali i hapjes se tenderit eshte publikuar ne web faqen e E-prokurimit me dt. 15.06.2020

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] Jo [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] Jo [ ]

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Pas marrjes se letres standarte per tenderusin e pasukseshem ne pajtueshmeri me nenin 108 A te LLP-se, me date 24.10.2020 kemi parashtruar ne Komunen e Lipjanit Kerkese per Rishqyrtim te publikimit te Njoftimi per dhenje te kontrates , por nga Autoritrti Kontraktues me Date 28.10.2020 na eshte kthyer Vendimi per Refuzimin e kesaj Kerkese.

Shtojce : Vendimi

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Sipas vlersimit profesional te kompanise , ***Grupi i OE "PARAJSA" SH.P.K& N.N.SH "EMSA"***, Autoriteti kontraktues – **KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN**, per kete tender **Ndërtimi i shtigjeve të ecjes rreth shtratit të lumit Sitnica**, ka bere shkelje ligjore te dispozitave te Ligjit Nr.05/L-068 per ndryshimin dhe plotsimin e Ligjit Nr.04/L-042 per

Prokurim Publik te Republikes se Kosoves , i ndryshuar dhe plotsuar me Ligjin Nr .04/L-237, me tutje Ligji i Prokurimit Publik.
Shkelja e dispozitave Ligjore nga **KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN** –Departamenti i Prokurimit kane te bejne me sa vijon :

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 64 i LPP-së
Neni 68 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së
Nenin nr. 9.1 & 9.2 i FDT-së

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar, ne me dt. 20.10.2020 ne platformën elektronike te prokurimit kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK, ku ne jemi shpallur si tenderues i eliminuar , ndërsa për kontratë eshte propozuar grupi i OE "EING COM SH.P.K; N.P.T DAQA"

Fillimisht ju sqarojmë se ne jemi eliminuar për arsye se kinse nuk i plotësojmë kriteret e dosjes se tenderit specifikisht :

Kerkesën nr. 5: **Autorizim nga prodhuesi per paisjet e lodrave dhe paisjet e fitnesit.**

Në vendimin e dt. 28.10.2020 AK-ja ka refuzuar kërkesën tonë për rishqyrtim duke e cilësuar si të pa bazuar.

Ju njoftojmë së nuk pajtohemi me vendimin e AK-së për arsye se ne e plotësojmë kërkesën e lartëpërmendur.

Ne jemi eliminuar me arysen sipas AK, citojmë: Ju ku e keni cekur se ne kemi ofruar variant, ndërsa nuk lejohet të ofroni dy prodhues të ndryshëm për paisjet e lodrave dhe paisjet e fitnesit.
Fillimisht ju sqarojmë se ne asnjë moment nuk kemi cekur se ne ofrojmë variant!
Ne kemi ofruar katalogun gjithashtu edhe autorizimin nga prodhuesi AVA PARK - Turqi, dhe pas kërkesës për sqarime shtesë të dt. 27.08.20, ne me dt. 27.08.2020 ju kemi përcjellur përgjigjjën tone në të cilën e kemi qartësuar dhe DEKLARUAR si prodhues të vetëm AVA PARK, ndërsa për prodhuesin Falgeo kemi sqaruar se ka mbetur aksidentalisht sikur pjesë e dosjes, pra nuk kemi përmendur variante, andaj e plotësojmë këtë kërkesë plotësisht.

Eliminimi jonë sipas sqarimit në lidhje me këtë pikë është i papranueshëm për ne për vet faktin se si ka mundësi që njëherë kërkohen sqarime rreth kësaj pike (sipas vendimit të OSHP nr. 454/20) dhe pas sqarimeve tona na jemi shpallur fitues, ndërsa pas rivlerësimit të dytë ne jemi eliminuar me pretekstin se nuk kemi plotësuar kërkesën në fjalë dhe se sqarimet tona nuk qëndrojnë.

Gjithashtu, GOE i rekomanduar për kontratë EING COM SH.P.K; N.P.T DAQA është i papërgjegjshëm për arsyet si në vijim:

I mungon një Kamion transportues me peshë bartese mbi 10 m3.
GOE i propozuar për kontratë ka prezantuar vetëm një kamion sipas kërkesës në FTD, ndërsa kamionat tjerë sic janë ai me targa 01-419-AI – Kamion i render 2 Dyer, nuk i plotëson kërkesat e dosjes sepse për dosjen në fjalë në bazë të paramasës kemi të bëjmë me gërmime të tokës pra me transportim të dheut e tjt dhe automjeti i fundit në fjalë në bazë të hulumtimeve tona në internet në bazë të të dhënave në librezë del të jetë gjysmë rimorkio dhe jo kamion sic ka qenë kërkesa. Ndërsa kamionat tjerë të cilët i kanë paraqitur nuk e mbulojnë kërkesën për peshë bartëse mbi 10 m3, pra janë më të vogla.

Gjithashtu sa i përket makinerisë – Lugë ngarkuese Marka: Liebherr L506, arsyetimi i OE me pretekstin se QRA nuk janë duke lëshuar tabela dhe se kanë dorëzuar kontrollën teknike dhe sigurimin e për makineri nuk është i qëndrueshëm.
Dëshmia për këtë pikë ka qenë: **Deshmia 3. Lista e paisjeve e nenshkruar dhe vulosur nga OE, per automjetet qe nuk regjistrohen Deklaratat unike doganore apo faturat e blerjes. Për automjetet qe regjistrohen Librezat e qarkullimit me validitet.**
Pra GOE i propozuar për kontratë nuk ka prezantuar asnjërën nga dokuementet e kërkuara në FTD por ka prezantuar një kontrollim teknik dhe sigurim të makinerisë që për neve ky sqarim nuk qëndron as për faktin se si ka mundësi që QRA për regjistirmin e automjeteve tona ka lëshuar tabela para dt. të dorëzimit të ofertës, ndërsa për këta jo?! As arsyetimi i AK nuk qëndron për këtë pikë sepse edhe para datës së dorëzimit të ofertës ka qenë i mundur regjistrimi i mjeteve, pra kushtet kanë qenë te krijuara sepse ne vetë pak ditë para dt. së dorëzimit të ofertës kemi regjistruat makinerië tonë: Traktor 4x4 e që dëshmohet me librezë prandaj ky sqarim është i papranueshem!

Gjithashtu GOE të propozuar për kërkesën: **Traktor 4x4 per bartjen e materialeve pergjat shtratit te lumit (min 1 cope),** ka dorëzuar një Traktor LOPAT 4x4, ndërsa jo tractor 4x4 per bartjen e materialeve sic edhe ka qenë kërkesa, pretendim i joni qe Traktor me lopat hyn ne kategorin e ngarkusve ky të cilin AK as nuk e ka marrur fare për bazë dhe nuk e ka arsyetuar!

Duke u bazuar në të gjitha faktet e lartcekura shihet qartë se ne jemi diskriminuar në këtë aktivitet të prokurimit sepse ne i plotësojmë të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, gjithashtu jemi edhe OE më i lirë se të gjithë OE të cilët kanë ofertuar ndërsa jemi më i lirë se OE i rekomanduar për kontratë për afro 29,000.00€.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët** sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Gjithashtu AK nuk e ka respektuar edhe nenin 7 i LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit

për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi, ndërsa eshte favorizuar OE i rekomanduar për kontratë.

AK ka vepruar në kundërshtim edhe me nenin 6 të LPP-së ku thuhet se "*Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit*"

Gjithashtu AK nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë

Në fund kërkojmë nga **ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT** që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e GOE **"PARAJSA" SH.P.K& N.N.SH "EMSA"**

ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në **Rishqyrtim** dhe **Rivlerësim** dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Grupi i OE "PARAJSA" SH.P.K& N.N.SH "EMSA" konsideron se menyra e eleminimit nga konkurrenca dhe mos respektimi i LLP-se gjate vlersimit te tendereve , na ka detyruar te angazhojme zyrtare dhe ekspert duke shkaktuar shpenzime ne pergaditjen e Kerkeses per Rishqyrtim , Ankeses per OSHP dhe per pergaditjen dhe hargjimin e kohes per pjesmarrje ne kete tender te cilat jane baze e shkaktimit te demit material dhe jo material , jemi te demtuar ne aspektin moral dhe material per shkak se neve kemi bere te gjitha pergaditjet e nevojshme per fillimin e punes si nga ana njerzore, teknike dhe furnizime te shumta me materialet e nevojshme per fillimin dhe perfundimin e punimeve sipas paramases!

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë"
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës"
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit